



D.P.Sh. „Eagle“
Numri i biznesit - 70349308
Drejtor – Valdet BRUTI
Eagle
Rr/Haki Taha, Nr. 1
Prizren

Ref:1807/638/LIC/ni

VENDIM

për ripërtitjen e licencës së KPM-së për Eagle, me seli në Prizren

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Eagle është operatorë i shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audivizuale përmes sistemit kabllorë, me seli në Prishtinë. KPM, me datën 1 gusht 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorë të shpërndarjes për Eagle.
3. Me datën 1 gusht 2018, skadon afati i licencës së Eagle, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtitjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 27 mars 2018, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, i ka njoftuar të gjithë të licencuarit lidhur me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtitje të Licencës së KPM-së.
5. Më 31 maj 2018, operatori i shpërndarjes Eagle ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtitje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi

6. Operatori i Shpërndarjes Eagle, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe në pajtim të plotë me procedurat e përcaktuara administrative nga KPM.
7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

Vendim

8. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 1 gusht 2018, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së Eagle, për të ushtruar veprimtarin e shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës.
9. Licenca e KPM-së për operatorin e shpërndarjes Eagle do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 1 gusht 2018.
10. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, shtrirja e rrjetit të operatorit të shpërndarjes Eagle, si dhe lista e kanaleve sipas katalogut që është pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI

Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



01.09.2018
datë